

1. *A mund të konfirmojë Ministria nëse ka pasur ndonjë deklaratë apo veprim nga Ministria apo zyrtarë të tjerë të Ministrisë që lidhet me familjarët e znj. Muca për shkak të raportimit të saj?*

**Përgjigje:** Në asnjë rast, si dhe specifikisht për rastin në fjalë për të cilin interesoheni, Ministria apo zyrtarë të tjerë të Ministrisë, nuk kanë bërë ndonjë deklaratë ndaj familjarëve të znj. Muca për shkak të raportimit të saj. Ministria është një institucion i administratës shtetërore që i përmbahet dhe vepron rigorozisht në përputhje dhe respektimit të parimeve që garantojnë ligjshmërinë, transparencën dhe mbrojtjen e të drejtave ligjore të punonjësve të saj.

**Znj. Muca** është specialiste në sektorin e raportimit dhe kordinimit pranë AKVMB, dhe bashkërendimi me Ministrinë e Bujqësisë dhe të Zhvillimit Rural për komunikimin me median është kompetencë e Drejtorit të Përgjithshëm, dhe kjo i është komunikuar verbalisht.

2. *Ju lutemi, na informoni mbi politikat dhe protokollet e Ministrisë për ndërveprimet me gazetarët dhe trajtimin e mbulimeve kritike.*

**Përgjigje:** Politikat dhe protokollet e Ministrisë me gazetarët dhe trajtimin e mbulimeve kritike zhvillohen në qasje të plotë me kërkesat ligjore lidhur me informimin.

Në faqen elektronike të Ministrisë gjenden të publikuara rregullisht informacione që përfshijnë çdo rast dhe nevojë që përbën interes publik. Gjithashtu edhe në faqet elektronike të institucioneve të varësisë mund të gjendet informacion i plotë dhe i përditësuar për çështjet me rëndësi për publikun e gjerë.

3. *Do të vlerësonim informacion mbi hapat që mund të ndërmerren nga Ministria për të adresuar këto pretendime.*

**Përgjigje:** Përtej imagjinatës apo cfarëdolloj insinuate të stisur pa arsye në media sociale, Ministria nuk administron asnjë pretendim të paraqitur zyrtarisht nga ndonje pale e interesuar. Ajo që mund të themi është se Ministria është maksimalisht e angazhuar dhe fokusuar në çuarjen përpara

**të reformave sektoriale të ndërmarra si dhe të informimit të qytetarëve mbi cdo situatë apo masa të ndërmarra për garantimin e sigurisë ushqimore.**

**Në dijeninë tonë nuk ka asnjë proces të ndërmarrë nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore pranë AKVMB.**